

Aneksi A**SHPALLJA E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS**

Tabela .1

Nr.	Pozicioni i punës	Struktura e interesuar/ Forca	Vendi ku ndodhet	Lloji i kontratës së punës	Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve		Afati i aplikimit	
					Me dosje	Intervista	Fillimi	Mbarimi
1	Ekspert Armatim-municioni	Reparti Ushtarak nr.6028, AIM	Tiranë	Pa afat	Po	Po	27.02.2025	13.03.2025
2								

Formulari nr. 1

1.Pozicioni i punës: Ekspert Armatim-Municioni
2. Kodi i pozicionit: N/A
3. Reparti/Institucioni: Drejtoria e Ekspertizës Teknike, në Agjencinë e Industrisë së Mbrojtjes.Reparti Ushtarak Nr.6028,
4. Vendi: Tiranë
5. Paga: VKM nr.325, datë 31.05.2023, i ndryshuar
6. Lloji i kontratës së punës: Pa afat
7. Data e fillimit të aplikimit: 27.02.2025
8. Data e mbylljes së aplikimit: 13.03.2025
9. Mënyra e aplikimit: Për të aplikuar kandidatët duhet të plotësojnë formularin e aplikimit, të cilin do ta gjejnë në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes, në adresën www.mod.gov.al . Formulari pasi plotësohet, së bashku me dokumentacionin përkatës,do të dërgohet në: <i>Drejtorinë e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve</i> <i>Ministria e Mbrojtjes, Rruga e Dibrës</i> <i>Tiranë</i>

10. Dokumentet e aplikimit:

Aplikantët duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- kërkesën;
- formularin e aplikimit;
- fotokopje të kartës së identitetit;
- diplomën e shkollës së lartë të noterizuar së bashku me listë notash;
- fotokopje të patentës nëse ka;
- dëshmi profesioni nëse ka;
- certifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja
- raport mjekësor;
- fotografi me përmasa 4x6, 2 copë dhe 9x12 2 copë;
- dëshmi penaliteti;
- vërtetim nga gjykata;
- vërtetim nga prokuroria;
- librezë pune;
- jetëshkrimin (CV).
- Letër motivimi
- formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në faqen e internetit të MM-së në adresën elektronike www.mod.gov.al. (linku: *Baza ligjore/Akte ligjore/ Integriteti i personave që ushtrojnë funksione publike/formulari i vetdeklarimit*)

11. Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës:

- a) të ketë shtetësinë shqiptare;
- b) të jetë jo më pak se 18 vjeç;
- c) të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar;
- d) të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kriterëve të miratuara;
- ç) të jetë i aftë për punë nga ana shëndetësore;
- e) të mos jetë i/e dënuar me burg me vendim gjykatë të formës së prerë për kryerje të një krimi;
- dh) të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda 1 viti nga data e aplikimit.

12. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:

- | | |
|-------------------|--|
| a. Grada/Titulli: | Ekspert Armatim-municioni. |
| Arsimi : | I lartë universitar “Master Shkencor” me 120 kredite, ose Diplomë e integruar e Nivelit të dytë në Inxhinieri Mekanike, Kimike, Shkenca Ushtarake ose fushë të ngjashme, me profil në armatim dhe municione edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë. |
| b. Kualifikimi: | Në fushën e lartëpërmendur të prodhimit dhe menaxhimit të armatimeve dhe municioneve. |
| c. Trajnimi: | Trajnime në fushën që lidhet me prodhimit e armatimeve dhe municioneve. |

- d. Eksperienca në Punë: Të ketë përvojë pune minimumi 10 vite eksperiencë në strukturat e forcave të armatosura, strukturat e sigurisë ose kompani të industrisë së mbrojtjes ku të ketë eksperiencë pune në dy ose më shumë nga këto fusha: prodhimit dhe menaxhimit të armatimeve dhe municioneve: vlerësimin e kushteve të sigurisë në strukturat e prodhimit dhe ruajtjes së armatimeve dhe municioneve: inspektimi teknik dhe operacional i objekteve të industrisë së mbrojtjes: hartim, mbikëqyrje dhe implementim të protokolleve të sigurisë për armët dhe municionet.
- e. Gjuha e huaj: Njohuri të mira të gjuhës Anglisht.
- f. Kërkesa të tjera specifike: Të ketë njohuri të mira në përdorimin e programeve kryesore të kompjuterit.
- g. Niveli i certifikatës së sigurisë: sipas VKM nr. 731, datë 27.11.2024 “Për miratimin e rregulores për sigurinë e personelit”.

Përshkrimi i punës: Eksperti i Armatim-Municionit ofron ekspertizë dhe mbështetje për zhvillimin, prodhimin, administrimin, ruajtjen, transportin, tjetërsimin, përmirësimin dhe përdorimin e armëve dhe municioneve, duke siguruar që aktivitetet të zhvillohen në përputhje me standardet e ndërveprueshmërisë, sigurisë, cilësisë dhe ligjit.

Detyrat kryesore:

- Harton dhe përditëson procedurat dhe protokollet për menaxhimin e armëve dhe municioneve, duke siguruar përputhshmërinë me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Vlerëson aktivitetet e prodhimit, ruajtjes dhe transportit të armëve dhe municioneve, si dhe garanton që këto procese janë të sigurt dhe në përputhje me rregulloret e sigurisë.
- Merr pjesë në inspektimin e strukturave dhe ambienteve që operojnë në sektorin e armatimeve dhe municioneve për të siguruar përputhshmërinë me standardet e ndërveprueshmërisë, sigurisë dhe cilësisë.
- Kryen analiza të aktiviteteve dhe proceseve që lidhen me armët dhe municionet dhe jep rekomandime për përmirësimin e efikasitetit dhe sigurisë.
- Përcjell zhvillimet teknologjike në industrinë e armatimeve dhe municioneve dhe përditëson protokollet e sigurisë për të përmirësuar praktikën e përdorur.
- Përgatit raporte mbi aktivitetet dhe realizimet teknike, duke ofruar rekomandime për përmirësimin e standardeve të ndërveprueshmërisë, sigurisë dhe cilësisë.
- Bashkëpunon me partnerët ndërkombëtarë dhe institucionet e sigurisë për të siguruar që praktikën dhe politikat janë të përditësuara dhe përmbushin standardet ndërkombëtare.
- Merr pjesë në hartimin dhe përmirësimin e politikave dhe rregulloreve të industrisë së armatimit dhe municionit, duke kontribuar në zhvillimin e rregulloreve për menaxhimin dhe kontrollin e sigurisë.
- Siguron që protokollet e sigurisë dhe teknologjitë e përdorura për armët dhe municionet të jenë të përditësuara dhe të përmbushin standardet ndërkombëtare për sigurinë e materialeve të tyre.
- Kryen detyra të tjera që lidhen me fushën e ekspertizës së armëve dhe municioneve dhe që ngarkohen me urdhër nga Drejtori i Përgjithshëm i AIM.

13. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një **komision vlerësimi** i përbërë nga 3 (tre) veta. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin:

- përzgjedhjen paraprake;
- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë.

Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët. Njësia e Burimeve Njerëzore verifikon dokumentacionin e aplikantëve, nëse ai është i plotë dhe i saktë, si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe përcakton kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit. Vetëm kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit do të njoftohen për vazhdimin e mëtejshëm të konkurimit.

Konkurimi me kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit të punës përfshin:

- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë.

Vlerësimi i tyre do të bëhet nga komisioni përkatës.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind), të cilat ndahen:

- a. 40 pikë, për vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve;
- b. 60 pikë, për intervistën e strukturuar me gojë.

Vlerësimi i dokumenteve të kandidatëve përfshin:

- a. vlerësimin ejetëshkrimit (CV);
- b. vlerësimin e kualifikimeve akademike, profesionale dhe teknike;
- c. vlerësimin e trajnimeve;
- d. vlerësimin e eksperiencave të ngjashme të punës;

Pikët totale të vlerësimit të dokumenteve ndahen, si më poshtë:

- a. jetëshkrimi, 5 pikë;
- b. arsimimi/kualifikimi, 15 pikë;
- c. trajnimi, 5 pikë;
- d. eksperiencia/përvoja në punë, 15 pikë.

Intervista, zhvillohet me gojë me të gjithë kandidatët që janë përzgjedhur gjatë fazës së përzgjedhjes paraprake. Qëllimi i intervistës është të verifikojë aftësitë, motivacionin dhe aspiratat

e çdo kandidati, si dhe përputhshmërinë e profilit profesional të kandidatit me pozicionin që do të mbulojë.

Intervista zhvillohet e strukturuar me qëllim që të sigurojë informacion të saktë rreth profilit profesional të kandidatëve. Ajo strukturohet në varësi të pozicionit që punonjësi do të mbulojë dhe eksperiencës.

Gjatë intervistës kandidatit i drejtohen disa pyetje nga anëtarët e komisionit, përgjigjet e të cilave vlerësohen me pikë. Çdo pyetje ka një sasi të caktuar pikësh, të cilat vlerësohen në varësi të përgjigjes. Në total intervista ka 60 pikë.

Kandidatët të cilët nuk marrin më shumë se **70 pikë**, (që përfshin vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, si dhe vlerësimin e intervistës), s'kualifikohen nga konkurimi.

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, tre kandidatët që kanë marrë më shumë pikë i paraqiten autoriteteve vendimarrëse për miratimin e kandidatit më të përshtatshëm për mbulimin e pozicionit të shpallur.

Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.